



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 2, datë 16.2. 2016

PËR

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,**  
**PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE, ME OBJEKT**  
**“RIKONSTRUKSION I PIKËS SË KALIMIT TË KUFIRIT**  
**EKZISTUES DHE NDËRTIMI I TERMINALIT TË RI DOGANOR**  
**“HANI I HOTIT”**

Në mbështetje të neneve 4, pika 8, shkronjat “a” e “b”, dhe 84, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit “Për përdorim burimi ujqor”, për veprimtari ndërtimore në brigje, Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit, me objekt “Rikonstruksioni i pikës së kalimit të kufirit ekzistues dhe ndërtimi i terminalit të ri doganor “Hani i Hotit”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA

